



DREJTORIA PËR SPORT

Nr. 16-670/01-144602/24 dt. 04 NOV 2024

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", më 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 29.1.3, shkronja d, të Rregullores së ndarjes së subvencioneve 01-020/01-19410/18 e dt. 08.08.2018, Drejtoria për Sport shpall:

K O N K U R S

PËR NDARJEN E BURSAVE PËR SHPRESAT E SPORTIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

I. Komuna e Prishtinës ndanë bursa për shpresat e sportit të Komunës së Prishtinës për vitin 2024, me vlerë 1000 Euro, në bazë të kriterëve të përcaktuara me këtë konkurs si;

II. KRITERET E PËRGJITHSHME:

1. Të jetë i regjistruar si sportist në një klub të pranuar nga federata përkatëse;
2. Të mos jetë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër ose të jenë të punësuar;
3. Të jetë banor i Komunës së Prishtinës;
4. Të jetë sportist me moshë 15-21 vjeç.

III. KRITERET E VEÇANTA:

1. Fitues nga Kampionatet/Garat Botërore të sporteve përkatëse, vlerësohet me 60 pikë;
2. Fitues nga Kampionatet/ Garat Evropiane të sporteve përkatëse, vlerësohet me 50 pikë;
3. Fitues nga Kampionatet/Garat Ballkanike të sporteve përkatëse, vlerësohet me 30 pikë;
4. Fitues nga Kampionatet/Garat Vendore të sporteve përkatëse, vlerësohet me 20 pikë;
5. Përfaqësues i Kosovës për grupmosha të caktuara, vlerësohet me 20 pikë;
6. Nxënësit/Studentët në asistencë sociale vlerësohen me 10 pikë.

7. Pjesëmarrës në gara ndërkombëtare, vlerësohet me 5 pikë;
8. Sipas kategorizimit të sporteve, vlerësohet me 10 pikë nga kategoria A, me 8 pikë nga kategoria B, me 6 pikë nga kategoria C dhe me nga 4 pikë nga kategoria D;
9. Nota mesatare e mësimëve/studimeve, vlerësohet me 3-10 pikë (Nota 2, tre pikë, nota 3, katër pikë, nota 4, pesë pikë, nota 5, shtatë pikë, studentet vlerësohen me 10 (dhjetë) pikë .`

Në kushtet dhe kriteret e njëjta të cekura në piken III, do të kenë përparësi nxënësit/studentët e familjeve të dëshmorëve, të viktimave civile të luftës, të veteranëve, të invalidëve të luftës, që nuk e kanë prindin në jetë dhe studentët që udhëtojnë nga fshati me larg se 15 km (Kritere të cilat duhen të dëshmohen).

IV. DOKUMENTET E DOMOSDOSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni sipas formës së Komunës;
2. Kopja e ID-së, së sportistit;
3. Certifikata e notave;
4. Deklarimi i nënshkruar se nuk është përfitues i ndonjë burse tjetër nga institucionet relevante;
5. Certifikata/Ekstrakti i lindjes;
6. Dëshmi për arritjet në fushën përkatëse të sportit;
7. Kopja e letërnjoftimit/pasaportës;
8. Vërtetimi nga administrata tatimore që nuk jeni në marrëdhënie pune (për personat mbi moshën 18 vjeçare);

Vërejtje: Dokumentet e pakompletuara sipas kriterëve të lartcekura, dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

Kandidatëve të cilëve iu ndahet bursa për kushtet e shfrytëzimit do të nënshkruajnë kontratë të veçantë, ku do të precizohen kushtet, obligimet dhe detyrat e dyanshme.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes: dt. 05.11.2024 deri me 19.11.2024. Aplikacioni merret dhe i plotësuar dorëzohet në sportelet e katit përdhës të Komunës të Pishinës (ndërtesa e vjetër), çdo ditë pune prej orës 08:00 deri 16:00.

Kushtrim Mushica

Drejtoria për Sport

Faqe 2 nga 2